

GJENDJA ME GRIPIN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, SEZONI 2024/2025 (java e katërbëdhjetë, deri më 06.04.2025)

TË DHËNA JAVORE


Mbikëqyrja epidemiologjike

Gjatë javës së katërbëdhjetë të vitit 2025 (nga 31.03-06.04.2025) në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë raportuar 319 ($I=17,4/100.000$) raste të të prekurve nga gripi/sëmundjet e ngjashme me gripin, për 37,6% më pak se javën e kaluar.

Krahasuar me javën e katërbëdhjetë të vitit të kaluar (153) numri është rritur për 2,1 herë, ndërsa sa i përket modelit për 14 sezonet e fundit (202) është regjistruar një rritje prej 58,2%.

Incidenca e aktivitetit sezonal të virusit të gripit korrespondon me aktivitet të ulët të virusit (Grafiku 1).

Grafiku 1. Niveli i intensitetit dhe shpërndarja javore e të sëmurëve me grip/ sëmundje të ngjashme me gripin sipas lakores epidemike të pritur 2010-2024, sezoni 2023/2024 dhe sezoni 2024/2025




174 raste janë regjistruar tek grupmosha 15-64 vjet, 60 tek fëmijët nga 5-14 vjet, 43 tek personat mbi 65 vjet dhe 42 tek fëmijët nga 0-4 vjet. Incidencë më e lartë ($43,5/100.000$) është regjistruar tek fëmijët nga 0-4 vjet dhe tek fëmijët nga 5-14 vjet - $27,9/100.000$.

Të sëmurët e kësaj jave janë regjistruar në 19 QSHP/NJR : Shkup – 120, Kumanovë – 30, Gostivar – 28, Tetovë – 23, ndërsa në të tjerat numri është ≤ 20 .

Në 13 njësi raportimi është regjistruar aktivitet shumë i ulët i virusit të gripit, në 6 sezonal. (hartogrami 1).

Hartogrami 1. Niveli i aktivitetit të virusit të gripit sipas incidencës në 100.000 banorë, java e katërbëdhjetë, 2025



Gjatë kësaj jave nuk janë raportuar raste të vdekjes së pasojë e gripit.

МБИКЌЫРЈА SENTINEL NDAJ SARI

Nga të gjitha vendet sentinel të cilat marrin pjesë, gjatë javës së katërbëdhjetë janë raportuar gjithsej 37 raste me SARI. Numri më i madh i rasteve me SARI (n=14; 37,8%) janë raportuar nga Klinika për sëmundje respiratore të fëmijëve - Kozle. Për sa i përket shpërndarjes sipas moshës, numri më i madh i rasteve me SARI (n=19; 51,4%) është regjistruar tek grupmosha 0-4 vjet.

Këtë javë, numri i përgjithshëm i pranimeve në vendet sentinel është 252, asnjë person nuk është i shtruar në kujdes intensiv. Nga të gjitha pranimet 14,1% janë si pasojë e SARI. Ngarkesë më e lartë është regjistruar tek fëmijët nga 0-4 vjet.

МБИКЌЫРЈА VIROLOGJIKE (rutinore + SARI)

Në javën e katërbëdhjetë, në laboratorin e virologjisë në ISHPRMV kanë arritur 34 materiale nga institucionet shëndetësore për testim për viruse respiratore nga mbikëqyrja rutinore dhe SARI.

Nuk janë regjistruar raste pozitive me grip.

Janë regjistruar 5 raste me RSV, në 4 RSV-A dhe në 1 RSV-B.

ТЃ DHЃNA KUMULATIVE

Mbikëqyrja epidemiologjike

Në sezonin 2024/2025 numri i përgjithshëm i rasteve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin është 25.330 (I=1.379,1/100.000).

Krahasuar me periudhën e njëjtë të sezonit të kaluar (n=14.643), numri i rasteve të regjistruara ka shënuar një rritje prej 72,6%, ndërsa krahasuar me modelin për 14 vjetët e fundit (n=20.589) është regjistruar një rritje prej 23,0%.

Të sëmurë janë raportuar nga gjithsej 29 QSHP/NJR. Numri më i madh (n=6.750) është regjistruar në Shkup, ndërsa incidencë më e lartë kumulative (5.535,2/100.000) është regjistruar në territorin e Dibrës (1.059).

Sa i përket shpërndarjes së rasteve sipas grupmoshave, numri më i madh i të sëmurëve është regjistruar tek personat e grupmoshës që përfshijnë pjesën më të madhe të popullatës (nga 15-64 vjet) – 14.502 raste (57,3%), ndërsa incidencë më e lartë (3.026,3/100.000) tek fëmijët e moshës 0-4 vjet (n=2.921).

Shpërndarja e rasteve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin sipas muajve:

- tetor – 195 raste ose 0,8%
- nëntor – 259 raste ose 1,0%
- dhjetor – 570 raste ose 2,3%
- janar – 7.710 raste ose 30,4%
- shkurt - 11.210 raste ose 44,3%
- mars – 5.067 raste ose 20,0%
- prill (deri më 06.04.2025) – 319 raste ose 1,2%.

Deri më tani janë regjistruar 5 raste të vdekjes si pasojë e gripit.

MBIKËQYRJA SENTINEL NDAJ SARI

Mbikëqyrja sentinel zbatohet si mbikëqyrje shitesë e sistemit të rregullt të mbikëqyrjes së gripit dhe COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e që ka për qëllim fitimin e informacionit më të detajuar për incidencën, intensitetin, llojin e viruseve që qarkullojnë dhe për zbatimin e masave parandaluese në kohë. Mbikëqyrja sentinel SARI kryhet në 6 spitale mbikëqyrëse, 5 në Shkup (KU e Sëmundjeve Infektive dhe Gjendjeve Febrile, KU për Sëmundjet e Fëmijëve, KU e Alergologjisë dhe Pulmologjisë, SPQ 8 Shtatori dhe KU për Sëmundje Respiratore tek Fëmijët - Kozle) në një në Shtip (SK Shtip). Definicioni për rastet SARI sipas të cilit zbatohet mbikëqyrja është në përputhje me definicionin e rastit të dhënë nga OBSH-ja në vitin 2014.

Nga të gjitha vendet sentinel të cilat marrin pjesë, gjatë javës së katërmëdhjetë janë raportuar gjithsej 1.126 raste me SARI, me 20 persona në kujdes intenziv. Numri më i madh i rasteve me SARI (n=450; 40,0%) janë raportuar nga Klinika për sëmundje tek fëmijët. Për sa i përket shpërndarjes sipas moshës, numri më i madh i rasteve me SARI (n=564; 50,1%) është regjistruar tek grupmosha 0-4 vjet.

Këtë javë, numri i përgjithshëm i pranimeve në vendet sentinel është 6.506. Nga të gjitha pranimet, 17,3% janë si pasojë e SARI. Ngarkesë më e lartë prej 20,5% është regjistruar tek personat e grupmoshës nga 0-4 vjet.

Janë regjistruar 9 raste të vdekjes, 2 në moshë nga 30-64 dhe 7 mbi 65 vjet, me komorbiditete dhe të pavaksinuar. Tek katër prej tyre është vërtetuar Influenza, dhe atë: 2 raste me Influenza A(H3), 1 me Influenza A(H1)pdm09 dhe 1 me Influenza A - e patipizuar.

MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE (rutinore + SARI)

Nga fillimi i sezonit 2024/2025, deri në javën e katërmëdhjetë, në laboratorin e virologjisë në ISHPRMV kanë arritur 1.122 materiale nga institucionet shëndetësore për testim për viruse respiratore nga mbikëqyrja sentinel dhe SARI.

Të gjitha materialet janë testuar edhe për prani të virusit të gripit, SARS-CoV-2 dhe / ose RSV.


Janë detektuar 283 raste pozitive me grip. (Tabela 1)

Janë regjistruar 10 raste pozitive me SARS-CoV-2 dhe 93 raste me RSV.

Tabela 1. Shpërndarja, numri dhe përqindja e materialeve pozitive nga mbikëqyrja rutinore dhe sentinel sipas origjinës dhe numrit, RMV, 2024/2025

Lloji dhe nënloji i virusit	Origjina		Sezoni 2024/25	
	rutinor	Sentinel SARI	numri	%
Influenza A	86	86	172	60,8%
Influenza A/H1pdm	15	25	40	23,3%
Influenza A/H3	64	54	118	68,6%
Influenza A – e pasubtipizuar	7	7	14	8,1%
Influenza B	80	31	111	39,2%
Influenza B Victoria	79	31	110	99,1%
Influenza B – linjë e papërcaktuar	1	0	1	0,9%
SARS-CoV-2	6	4	10	-
RSV	15	78	93	-
RSV-A	9	54	63	67,7%
RSV-B	6	24	30	32,3%

Grafiku 2. Shpërndarja javore, numri dhe përqindja e mostrave pozitive të gripit, mbikëqyrja sentinel dhe rutinor, RMV, 2024/2025



KOMENT EPIDEMIOLOGJIK

Numri i sëmundjeve të ngjashme me gripin, po shënon rënie por vazhdon të jetë mbi kufirin javor për aktivitetin sezonal. Rezultatet e mbikëqyrjes virologjike të gripit tregojnë se ka një aktivitet rajonal të virusit të influencës. Sipas këtyre të dhënave, Maqedonia e Veriut ka intensitet mesatar të virusit të gripit.

MASA TË PËRGJITHSHME PËR PARANDALIM

*Burimi : <https://sezonskigrip.mk/>

Masat e përgjithshme për mbrojtjen nga gripi kanë për qëllim mbrojtjen nga sëmundjet akute të frymëmarrjes dhe nga ato mund të ketë përfitime të mëdha, veçanërisht nëse zbatohen gjatë gjithë periudhës së dimrit:

- Shmangni mbledhjen dhe qëndrimin në dhoma ku qëndrojnë më shumë njerëz, veçanërisht shmangni kontaktin e ngushtë me njerëz të sëmurë ose të dyshimtë – me kollë, teshtimë, temperaturë të lartë të trupit.
- Lani duart shpesh me sapun dhe ujë ose dezinfektues.
- Mjediset e banimit mbani të ngrohura dhe ajrosni ato shpesh.
- Vishuni me veshje të ngrohta me shtresa dhe larje me ujë të ngrohtë.
- Konsumoni pije të ngrohta (çaj dhe supë), lëngje frutash dhe ujë me limon.
- Hani produkte të freskëta të pasura me vitamina dhe minerale, më së miri fruta dhe perime që janë më të mira për trupin. Produktet e pasura me vitaminë C (limon, portokall) janë ato që rekomandohen më shumë. Nëse produktet ushqimore të freskëta nuk janë gjithmonë në dispozicion, mund të përdoren edhe pije dhe preparate me multivitamina.
- Bëni një stil jete dhe zakonesh të shëndetshme, pushoni dhe fleni irë, ushqehuni shëndetshëm, bëni aktivitetit fizik dhe ruajeni qetësinë mendore dhe reduktoni stresin.

Imuniteti i mirë i trupit do t'ju ndihmojë të qëndroni të shëndetshëm ose të përballeni më lehtë me gripin dhe sëmundjet e ngjashme me gripin. Megjithatë, edhe nëse jeni plotësisht i shëndetshëm dhe keni një sistem të fortë imunitar, prapëseprapë mund të infektoheni me grip ose një sëmundje të ngjashme me gripin.

Çfarë duhet të bëni nëse sëmureni nga gripi?

Ndiqu këto rekomandime:

- Qëndroni në shtëpi dhe mos shkoni në punë, shkollë apo vende ku ka shumë njerëz.
- Pushoni dhe konsumoni shumë lëngje dhe ushqime të lehta.
- Shmangni kontaktin e ngushtë me njerëzit me të cilët jetoni, mos pranoni vizitorë gjatë kohës që jeni të sëmurë.
- Mbuloni hundën dhe gojën me një fasuletë kur kolliteni dhe teshtini. Pas përdorimit, hidheni atë në koshin e plehrave.
- Mbani maskë mbrojtëse kur jeni në kontakt me të afërmit tuaj në shtëpi, kur kolliteni dhe teshtini.
- Praktikoni larjen e shpeshtë dhe të plotë të duarve me ujë të ngrohtë dhe sapun.
- Përdorni peceta të lagura që përmbajnë alkool ose dezinfektues duarsh.
- Shmangni prekjen e syve, hundës dhe gojës me duar.

- Ajrosni shpesh dhomën në të cilën qëndroni gjatë kohës që jeni të sëmurë.
- Mbani mjedisin tuaj të pastër – gjësendet, sipërfaqet me produkte higjienike shtëpiake.

Nëse jeni mbi 65 vjeç ose keni sëmundje kronike, ose nëse simptomat e sëmundjes përkeqësohen ose zgjasin për disa ditë - kërkoni ndihmë nga mjeku.

VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT SEZONAL

Vaksinimi kundër gripit është mbrojtja më e mirë nga kjo sëmundje, prandaj Instituti i shëndetit publik e rekomandon atë për të gjithë popullatën, sidomos për personat që përkasin në grupet vullnerable (sipas rekomandimeve të OBSH-së):

- Personat e moshuar (mbi 65 vjet)
- Fëmijët në moshë nga 6 deri në 59 muaj
- Personat mbi 6 muaj e me sëmundje kronike
- Gratë shtatzëna dhe
- Punonjësit shëndetësorë.

Për sezonin 2024/2025, Ministria e shëndetësisë siguroi 70 000 doza të vaksinë katërvalente falas për këto kategori të popullatës. 10.000 doza shtesë të vaksinës katër valente janë siguruar përmes donacionit nga PIVI (Partnership for Influenza Vaccine Introduction).

Vaksinimi kundër gripit për sezonin 2024/2025 filloi në 21.10.2024 dhe zbatohet në Shtëpitë e shëndetit dhe/ose Qendrat e shëndetit publik me Njësitë e tyre rajonale. Caktimi i termineve për vaksinat falas bëhet nëpërmjet uebfaqes www.vakcinacija.mk.

Sipas Drejtorisë për Shëndetësi Elektronike nga fillimi i vaksinimit e deri në mbylljen e këtij raporti gjithsej janë vaksinuar 70.376 persona që bëjnë pjesë në kategoritë e grupeve të cënueshme të popullatës.

2.600 vaksina komerciale shtesë janë siguruar nga ana e Qendrave të shëndetit publik si vaksina për pjesën tjetër të popullatës dhe ato mund të merren për një kompensim financiar të caktuar në Qendrat e shëndetit publik dhe Njësitë e tyre rajonale.

Sa i përket vaksinave komerciale, deri më tani janë vaksinuar 1.918 persona.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë vaksinuar gjithsej 72.294 persona me vaksina falas dhe komerciale.

RAJONI EVROPIAN

*Burimi: <https://erviss.org/>

Raporti për gjendjen me gripin në Rajonin Evropian për javën e trembëdhjetë të vitit 2025 tregon se aktiviteti i virusit të gripit në Rajonin Evropian të OBSH-së:

- Shkalla e morbiditetit të gripit (ILI) dhe /ose infeksioneve respiratore akute është rritur mbi nivelet bazë në 15 nga 31 vende të rajonit evropian të OBSH-së.

- Edhe pse ka variacione në vende të ndryshme, numri i rasteve pozitive tashmë ka arritur kulminacion, por aktiviteti edhe i Influenza A edhe i Influenza B mbetet në nivel të lartë.
- Pozitiviteti i RSV mbetet mesatar në nivelin primar dhe sekundar të mbrojtjes shëndetësore. Regjistrohet një përqindje e rritur e pozitivitetit në mbikëqyrjen SARI tek personat mbi 65 vjet, edhe pse përqindje më e lartë vihet re tek grupmosha nga 0-4 vjet.
- Aktiviteti i SARS-CoV-2 mbetet i ulët në të gjithë rajonin, me variacione të caktuara në disa vende.
- Detektimet e vërtetuara të infektimeve me virusin e gripit nga ISHP sentinel gjatë javës së kaluar ishin A (52%) dhe B (48%). Nga Influenza A numri më i madh i rasteve janë A(H3) (75%) dhe A(H1)pdm09 (25%).
- Në rajon, nga mostrat e pacientëve të mbikëqyrjes ndaj SARI:
 - Përqindja e detektimit të virusit të gripit është 15% krahasuar me 16% që ishte gjatë javës së kaluar. Aktiviteti mesatar ishte 15% (shtrirja: 4-44%).
 - Detektimet e vërtetuara të infeksioneve me virusin e gripit nga SARI sentinel për javën e kaluar ishin Influenza A (66%) dhe Influenza B (37%). Nga mostrat e subtipizuara 35% ishin A(H1)pdm09 dhe 65% A(H3).
 - Pozitiviteti i SARS-CoV-2 ishte 1% krahasuar me 2% që ishte gjatë javës së kaluar. Aktiviteti mesatar ishte 1% (shtrirja: 0–7%).
 - Pozitiviteti i RSV është 7% krahasuar me 14% që ishte gjatë javës së kaluar. Aktiviteti mesatar ishte 7% (shtrirja: 4-20%).

Nga 34 vende të cilat raportojnë për intensitetin e gripit: 14 kanë raportuar për intensitet mesatar dhe të lartë.

Nga 33 vende të cilat raportojnë për shpërndarjen gjeografike të gripit: 27 kanë raportuar për shpërndarje të gjerë të virusit të gripit.

Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse
Instituti i Shëndetit Publik